



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

RAPORTI VJETOR

PËR

GJËNDJEN, SHFRYTËZIMIN, MONITORIMIN,
MIRËMBAJTJEN DHE SIGURINË E DIGAVE TË
MËDHA DHE DAMBAVE NË SHQIPËRI.

Viti 2024

Tiranë, Prill 2025

PËRMBAJTJA

- 1. Të përgjithshme**
- 2. Qëllimi i hartimit të Raportit vjetor dhe kuadri ligjor**
- 3. Gjëndja aktuale e digave dhe dambave të mëdha si dhe monitorimi dhe siguria e tyre**
- 4. Programi dhe aktivitetet e KKDM të zhvilluar gjatë vitit 2024**
- 5. Përfundime dhe Rekomandime**

Shtojcat:

- Shtojca 1 - Lista e digave të mëdha dhe shfrytëzuesit e tyre në Shqipëri, 2024.
- Shtojca 2 - Statistikat kryesore për digat e mëdha në Shqipëri, 2024.
- Shtojca 3 - Digat e mëdha me rrishtun shume te larte dhe te larte, 2024
- Shtojca 4 - Programi Vjetor i KKDM per vitin 2025

1. Të Përgjithshme

Territori hidrografik i Shqipërisë ka një sipërfaqe prej 44 000 km² ose 57 % më shumë se territori shtetëror i vendit. Në territorin hidrografik të vendit tone bien afro 1400 mm rreshje në vit të cilat furnizojnë 7 basenet ujore kryesore të vendit. Afro 35 % e prurjeve mesatare vjetore të ujit të burimeve natyrore, lumenjve dhe perrenjve të vendit tone përdoren për prodhim energjie ujore dhe vetëm 1 % e këtyre prurjeve përdoren për furnizimin me ujë të pijshëm. Me pak se 700 milion m³ ujë në vit përdoren për ujitje të tokave bujqësore.

Një rol shumë të rëndësishëm në rezervimin dhe administrimin e këtyre ujrave luajnë 351 digat e mëdha dhe afro 300 diga të vogla të ndërtuara kryesisht në vitet 1957 - 1990 të cilat përdoren për prodhimin e energjisë ujore dhe energji diellore, ujitje të tokave bujqësore, furnizimit me ujë të pijshëm, mbrojtjen nga përmytjet, rritjen e peshkut, transportin ujor, turizem dhe atrakcion urban. Rezervuarët e krijuar prej këtyre digave grumbullojnë dhe perpunojnë në total afro 5 miliard m³ në vit nga të cilat me se 85 % përdoret për prodhimin e energjisë.

Me numrin e digave të mëdha të përmendur më sipër, Shqipëria renditet ndër 6 vendet e para në Europë dhe ndër 20 vendet e para në botë me numrin total me të madh të digave të mëdha. Shqipëria është vendi që ka më shumë diga të mëdha në Europë për frymë dhe për 1000 km². Kjo specifikë për vendin tone në lidhje me numrin e digave dhe të rezervuarëve si dhe të vjetërsisë së tyre, kërkon një vëmendje dhe organizim të veçantë të këtij sektori i cili duhet të bazohet në eksperiencën e vendeve europiane që kanë një numër të madh digash dhe rezervuarësh siç janë Franca, Italia, Spanja dhe Zvicra. Për vetë rëndësinë ekonomike dhe rriskun e lartë që kanë digat e mëdha në rast prishje të mundshme të tyre apo të përmytjeve nga rreshjet e mëdha është e domosdoshme organizimi i këtij sektori me qëllim përmirësimin e procesit të shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe monitorimit të tyre si dhe rritjen e sigurisë së tyre.

Sipas Rregjistrimit Kombëtar të Digave të Mëdha të hartuar dhe aprovuar nga Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM), në vendin tonë aktualisht janë **351 diga të mëdha** të përcaktuara sipas Ligjit Nr.8681, datë 02.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, i përditësuar në datë 14.02.2003. Një listë e këtyre digave me të dhënat kryesore të tyre dhe rezervuarëve të krijuar prej tyre si dhe lista e 67 shfrytëzuesve të tyre për vitin 2024 jepet në aneksin 1 bashkelidhur këtij raporti

28 diga të mëdha përdoren kryesisht për prodhim energjie ujore (2 prej të cilave përdoren edhe për prodhim të energji diellore), 317 diga të mëdha përdoren kryesisht për qëllime ujitje të tokave (rezervuarët e 130 prej tyre përdoren edhe për peshkim), 4 diga të mëdha përdoren kryesisht për qëllime urbane dhe turistike dhe 2 diga të mëdha përdoren për furnizim me ujë të pijshëm. Duhet theksuar se me se 25 diga të mëdha për qëllime ujitje janë aktualisht jashtë funksionit.

Digat më të larta janë pjesë e kaskadave kryesore të ndërtuara në lumenjtë Drin, Devoll dhe Mat të cilat përdoren kryesisht për prodhim hidroenergjie. Njëkohësisht, ato janë edhe digat me rrezikun më të lartë për dëmtime në ekonomi dhe humbje në njerëz në rastet e ndonjë ngjarje natyrore katastrofike apo prishje të mundshme të ndonjë prej tyre. **Afro 300 000 njerëz banojnë në zonat urbane poshtë digave të tre kaskadave të mesiperme që mund të jenë në rrezik.**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

Sipas legjislacionit në fuqi dhe standarteve teknike nderkombetare, të gjitha **digat e mëdha sipas percaktimit të ligjit Nr. 8681, date 02.11.2000, janë vepra të rëndësishë së vecantë dhe kërkojnë marrjen e tërësisë së masave organizative, teknike dhe financiare** që të garantojnë shfrytëzimin normal të tyre, jetëgjatësinë më të madhe dhe mosçënimin e të tretëve gjatë fazës së ndërtimit dhe shfrytëzimit të tyre. Per vete percaktimin e mesiperm, marrja e masave të mesiperme është një domosdoshmëri që duhet të merret në konsideratë nga të gjithë shfrytëzuesit e digave në mënyrë të vecantë për sigurinë e tyre dhe planet e gadishmerisë në rastet e emergjencave civile. Duhet theksuar se vetëm 50 % e digave të mëdha që përdoren për prodhim energjie ujore kanë të instaluar sistemet e alarmit ndërsa të gjitha digat që përdoren për qëllime ujëtare, furnizim me ujë, qëllime turistike dhe urbane si dhe 50 % e digave që përdoren për prodhim energjie ujore nuk kanë të instaluar asnjë lloj sistemi alarmi

Aktualisht, Digat e mëdha administrohen dhe përdoren nga **67 operatorë të ndryshëm** ku:

- 1 operator është operator publik shtetëror (KESH sh.a.) që administron 6 digat e kaskadës së lumit Drin të cilat përdoren kryesisht për prodhim energjie. Tre rezervuarët e krijuar prej këtyre digave përdoren edhe për turizëm, transport ujor, ujëtarë të tokave bujqësore në zonën e Shkodrës dhe peshkim,
- 1 operator është operator publik shtetëror (MBZHR) që administron 8 diga të mëdha që përdoren kryesisht për ujëtarë por 2 prej rezervuarëve të krijuar prej tyre përdoren edhe për prodhim energjie nga operatore private që i kanë marrë me koncesion. Gjithashtu, MBZHR ka nën administrim edhe kompleksin hidroteknik të Ashtes të përbërë nga një argjinturë mbrojtëse me gjatësi më se 2600 m dhe cila krijon një rezervuar ujë me volum prej më se 2 milion m³. Ky kompleks shfrytëzohet për prodhim energjie nga kompania austriake Verbund si dhe për ujëtarjen e tokave bujqësore në rrjedhën e poshtme të lumit Drin duke përfshirë edhe zonën e Vaut të Dejes
- 1 operator është operator privat (KURUM sh.p.k.), që përdor 3 diga të mëdha dhe një kanal derivacioni në Bistrice me anë të të cilave shfrytëzohet në formë kaskade ujëtarët e lumenjve Mat dhe Bistrice për prodhim energjie.
- 7 operatorë janë operatore private që i kanë marrë me koncesion për prodhim energjie ujore, (Devolli HP, AYEN, Inerte Lumzi, Diteco, Teodori 2003, Hydroenergy, Favina.),
- 2 operatorë të digave të mëdha që përdoren për furnizimin me ujë janë ndërmarrjet e Ujësjellës - Kanalizimeve UK Durrës dhe UK Tiranë.
- 55 operatorë të digave të mëdha janë 55 Bashki në të gjithë vendin që administrojnë 323 diga të mëdha për ujëtarë, peshkim, qëllime urbane dhe turistike si dhe afro 300 digat e vogla që janë dhënë përmes VKM Nr. 1108, datë 30.12.2015,

Gjithashtu, sipas informacioneve të dhëna nga MIE, rezulton se janë në shfrytëzim 4 damba të mëdha që administrohen dhe përdoren nga **3 operatorë të ndryshëm. Për këto damba, nuk ka asnjë informacion nga shfrytëzuesit e tyre dhe nga MIE.**

2. Qëllimi i hartimit të Raportit vjetor dhe kuadri ligjor

Qëllimi kryesor i përgatitjes së këtij raporti vjetor, është për të informuar Këshillin e Ministrave për gjendjen dhe problematikat e digave të mëdha dhe dambave duke përfshirë jo vetëm aspekte të kontrollit dhe monitorimit të tyre, por edhe domosdoshmërinë për një reformë të thellë e të plotë institucionale, organizative dhe ligjore në institucionet përgjegjëse për kontrollin e shfrytëzimit, monitorimit, mirëmbajtjes dhe sigurisë e tyre. Qëllimi i kësaj reforme është përmirësimi i procesit të kontrollit dhe monitorimit të tyre dhe institucionet shtetërore dhe shfrytëzuesit e digave si dhe rritjes së sigurisë në zonat poshtë tyre duke ju pershtatur kërkesave të legjislacionit Europian.

Njekohesisht, në këtë Raport do të jepen disa përfundime dhe rekomandimet përkatëse për ecurinë normale dhe përmirësimet e nevojshme në këtë sektor të rëndësishëm për ekonominë e vendit dhe sigurinë e njerezve i cili perballët me probleme të shumta në lidhje me kontrollin, shfrytëzimin, monitorimin dhe sigurinë e digave të mëdha.

Gjithashtu, KKDM kërkon të sensibilizojë aktoret kryesore përgjegjëse për rëndësinë e sigurisë dhe monitorimit të digave, vlerat e mëdha ekonomike që kanë në përdorim si dhe për pasojat e rënda që mund të ketë nga mungesa e mirëmbajtjes, kontrollit dhe monitorimit të tyre.

Për përgatitjen e Raportit Vjetor të vitit 2024 për Gjendjen, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe Sigurinë e Digave dhe Dambave në Shqipëri, KKDM është bazuar në legjislacionin në fuqi si me poshte.

Ligjet:

- Ligji Nr. 8681, dt. 02.11.2000 “Për Projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, i përditësuar në dt.14.02.2013.
- Ligji Nr. 10431, date 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.
- Ligji Nr. 111/2012, date 15.11.2012 “Mbi Menaxhimin e integruar të Burimeve Ujore” i përditësuar me ligjin Nr.6/2018,
- Ligji Nr. 242, date 09.03.2017 “Për Administrimin e Ujitjes dhe Kullimit”,
- Ligji Nr. 45, datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen Civile”

Vendimet e Këshillit të Ministrave

- VKM Nr. 147, datë. 18.03.2004 “Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe dambave”,
- VKM Nr. 278, datë 18.05.2005 “Për Rregulloren e funksionimit të KKDM dhe KTPD”
- VKM Nr. 406, date 19.06.2019 “Për Struktura të KKDM”
- VKM Nr. 1108, datë 30.12.2015 “Për transferimin e sistemeve dhe digave të ujitjes tek pushteti lokal”,
- VKM Nr. 168, datë 24.03.2023 “Për Miratimin e vlerësimit të rrishtit nga fatkëqesite në nivel qendror”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

Rregullore, Udhëzime dhe rekomandime të KKDM dhe të ICOLD

- Udhëzimi i përgjithshëm për hartimin dhe permbajtjen e pasaportave të digave të mëdha i miratuar me Vendim të KKDM Nr. 2, date 21.02.2020
- Udhëzimi i përgjithshëm për hartimin e rregulloreve teknike të shfrytëzimit, mirembajtjes dhe kontrollit të digave të mëdha i miratuar me Vendim të KKDM Nr. 3, date 19.10.2020
- Udhëzimi i përgjithshëm për hartimin e Planeve të gadishmerise në rastet e emergjencave civile (PGEC) i miratuar me Vendim të KKDM Nr. 5, date 16.11.2020
- Rregullore për monitorimin e digave pas Termetit i miratuar me Vendim të KKDM Nr. 6, date 16.11.2020
- Udhëzimi i përgjithshëm për hartimin dhe permbajtjen e pasaportave të dambave të mëdha i miratuar me Vendim të KKDM Nr. 8, date 21.12.2020
- Klasifikimi i digave sipas rriskut sizmik i miratuar me Vendim të KKDM Nr. 15, date 15.02.2021
- Standartet Teknike në lidhje me prurjet kontrolluese në sistemet e Shkarkimit të ujrave i miratuar me Vendim të KKDM Nr. 36, date 25.10.2023
- Buletinet Nr. 60 - 205 të ICOLD për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin, monitorimin dhe sigurinë e digave dhe rezervuareve.

3. Gjëndja aktuale e digave dhe dambave të mëdha si dhe monitorimi dhe Siguria e tyre gjatë vitit 2024

Bazuar në Raportet Vjetore të ardhura nga 40 Shfrytëzues të digave (vetëm 60 %) të cilet administrojnë afro 225 diga të mëdha (afro 64 % të numrit total të digave të mëdha), si dhe nga inspektimet dhe kontrollat kryera nga KKDM dhe ITD gjatë vitit 2024, dëshirojmë t'ju informojmë se në përgjithësi **digat e mëdha, me përjashtim të 50 % të digave të mëdha për prodhim hidroenergjie (Digat e mëdha të ndertuara në lumenjte Drin, Devoll dhe Mat dhe Bistrice), nuk monitorohen dhe nuk mirëmbahen nga shfrytëzuesit e digave sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi duke sjellë jo vetëm përkeqësim të gjendjes së tyre për shkak të vjetërsisë dhe mungesës së mirmbajtjes por dhe krijimin e problemeve të ndryshme në elementet kryesore të tyre sic janë veprat e marrjes së ujit apo sistemet e shkarkimit. Gjithashtu në të gjitha digat e mëdha që përdoren për ujë, furnizim me ujë dhe qelime urbane nuk ka të instaluar sisteme alarmi për të shmangur problematikat që mund të shkaktohen në rastet e emergjencave civile në zonat urbane poshtë tyre. Kjo situatë është më problematike në digat që përdoren dhe janë në pronësi të bashkive të vendit të cilat kanë treguar gjatë këtij viti një neglizhencë në mirëmbajtjen dhe monitorimin e tyre. Megjithatë nga buxheti i shtetit u vu në dispozicion një fond emergjent për digat në vlerën prej afro 500 milion Leke rezultoi se vetëm afro 10 % e këtij fondi është shfrytëzuar. Në këto bashki vërehen edhe probleme të mëdha që lidhen me mungesën e inxhinierëve dhe njësisë të kontrollit teknik të digave. Nga Kontrolli dhe Inspektimi i digave të mëdha gjatë vitit 2024 rezultoi se më së shumti 25 diga të mëdha dhe afro 90 diga të vogla janë jashtë funksionit. Gjithashtu, një problem që nuk po gjen zgjidhje është fakti i mungesës së informacionit për rezultatet e kontrollit në digat nga MIE dhe MBZHR që mbulojnë destinacionin dhe fushën e qelimit për ndertimin dhe shfrytëzimin e digave dhe dambave të mëdha sic kërkohej në nenin 10 të ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 të mesiperm dhe nenin 4 të VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 të përmendur më sipër**

Fakti që afro 40 % e bashkive që administrojnë digat e mëdha nuk përgatitin dhe nuk dorëzojnë raportin vjetor për gjendjen e digave të mëdha të kërkuar në legjislacion, tregon më së miri neglizhencën dhe pafundësinë e tyre për administrimin, kontrollin dhe monitorimin dhe sigurinë e këtyre digave. Ndër bashkitë që nuk kanë sjellë raporte vjetore për gjendjen dhe monitorimin e digave të mëdha gjatë vitit 2024, mund të përmendim **Bashkitë e Elbasanit, Beratit, Durrësit, Korçes, Tepelenës, Finiqit dhe Peqinit të cilat prej më së dy vitesh nuk e shohin të arsyeshëm plotësimin e kërkesave ligjore për dergimin e informacionit në lidhje me gjendjen e digave që kanë nën administrim. Nga inspektimet në terren, rezultoi se në digat e administruara nga këto bashki nuk ka të instaluar asnjë sistem të monitorimit të digës apo rezervuarit dhe puna e ekipeve të tyre është mjaft e dobët. Në shumë prej këtyre bashkive, sipas inspektimeve të kryera nga KKDM ka shumë diga që nuk përdoren dhe janë jashtë funksionit për probleme teknike të vogla si dhe për neglizhencë të përdoruesve të tyre.**

Duhet të theksojmë se edhe Raportet vjetore të ardhura pranë KKDM nga bashkitë janë me mangësi dhe tregojnë problematikat të theksuara në drejtim të kontrollit, monitorimit dhe sigurisë së tyre sipas kërkesave ligjore.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

Asnjë prej bashkive të mesiperme nuk kanë bërë trajnime të stafit teknik të tyre që prej marrjes në pronësi të këtyre digave në vitin 2015 nga MBZHR. Në shumicën e bashkive mungon dokumentacioni teknik për digat (projekti i detajuar, të dhënat e monitorimit ndër vite, etj), i cili nuk është dorëzuar nga MBZHR në periudhën e transferimit të aseteve të digave sipas kërkesave të VKM Nr. 1108, datë 30.12.2015.

KKDM ka vërejtur se **procesi i transferimit të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të digave të ujitjes** si pjesë përbërëse e infrastrukturës së ujitjes i kryer në bazë të VKM Nr. 1108, datë 30.12.2015 që prej 10 vitesh **nuk ka sjellë asnjë përmirësim në përdorimin, mirëmbajtjen, monitorimin dhe sigurinë e tyre**. Thëksojmë se në këtë proces ka munguar edhe një vlerësim i aseteve të këtyre digave si dhe kontrolli dhe drejtimi i duhur i procesit nga prefekturat. **Per me se 96 % të digave të medha dhe rezervuareve të krijuar prej tyre nuk është kryer asnjë vlerësim i aseteve apo rregjistrim në rregjistrin kadastral. Njekohesisht, asnjë prej rezervuareve të ujit të administruara nga bashkitë nuk është i rregjistruar në kadastrën e ujit.**

Kërkesat për dorëzimin e dokumentacionit teknik dhe rregjistrimi i digave dhe rezervuareve si aset të paluajtshme që janë detyrime ligjore dhe kërkesa të VKM Nr.1108, nuk janë kryer edhe sot nga MBZHR dhe prefekturat përkatëse të cilat kishin për detyrë kryerjen e një procesi korrekt, profesional dhe në përputhje me kërkesat e ligjit dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave. Kjo situatë nuk justifikon mungesën e masave të mesiperme edhe sot nga bashkitë për përgatitjen e këtyre dokumentave të kërkuara nga legjislacioni në fuqi dhe nga KKDM përmes shkresave dhe udhëzimeve të dhëna edhe gjatë vitit 2024. Gjatë tre viteve të fundit, KKDM ka mundur të përgatitë një pjesë të mirë të pasaportave të digave të medha.

Aktualisht ndodhemi përpara faktit që asetet e digave të mëdha nuk janë të vlerësuara dhe të rregjistruara në Agjencinë Kombëtare të Kadastrës apo në AMBU që zoteron Kadastrën Ujore. Të gjitha bashkitë nuk kanë dërguar asnjë të dhënë në lidhje me vlerën e këtyre aseteve. Megjithatë kërkesat e here pas herëshme të KKDM, **nuk ka një vlerësim dhe regjistrim të aseteve të digave të mëdha dhe rezervuareve të tyre.**

Një problem shqetësues është **vjetërsia e digave të medha** që përdoren për ujitje. Me se 110 diga të mëdha që përdoren për ujitje të cilat janë me material vendi, janë ndërtuar para 50 viteve në një kohë që projektimi i tyre sipas standarteve teknike të kohës për këto lloje digash kanë qenë të projektuar për jo më shumë se 50 vjet. Kjo situatë kërkon rivlerësimin sa më të shpejtë të jetë e mundur e kushteve aktuale të tyre sipas standarteve bashkëkohore.

Thëksojmë se **një problem i madh vazhdon të jetë mungesa e monitorimit të digave të medha që përdoren për ujitje** dhe peshkim dhe sidomos mungesa e instrumentave të monitorimit në këto diga ka sjellë edhe mungesën e një baze të të dhënave të monitorimit të tyre.

KKDM ngre shqetësimin se 97 % e digave të medha që përdoren për ujitje, peshkim apo qellime urbane dhe turistike nuk kanë të instaluar asnjë instrument për monitorimin e këtyre digave. Mjaft shqetësues është fakti se në disa diga të medha që kanë edhe një rrisht shumë të lartë për zonat urbane poshtë tyre nuk ka të instaluar asnjë instrument për monitorimin e tyre. Mund të përmendim digën e liqenit Artificial të Tiranës, Digën e Farkës dhe digën e Kasharit në Tiranë, digën e Paskuqanit në Kamez, digat e Lumarit në Mallakastër, digën e Tapizes në Krujë apo digat e medha në bashkitë e Durrësit, Elbasanit, Beratit dhe Shijakut, Korce, Gjirokastrë dhe Finiq.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

Theksojme se edhe digat e ujitjes qe administrohen nga MBZHR nuk kane dorezuar prej me se 10 vitesh ndonje baze te dhenave te monitorimit te ketyre digave megjithese ato jane te ndertuara perpara me se 50 vitesh.

Nga Raportet vjetore te ardhura nga 32 bashki qe admnistrojne diga te medha rezulton se problemet kryesore jane demtimet ne shkarkuesit e tyre. Rreshqitjet dhe filtrimet ne trupin e digave si dhe mosfunksionimi i veprave te marrjes se ujit. Nder digat e medha me probleme jane identifikuar digat e Rubjekes, Bilalas dhe Koxhas ne Shijak, Diga e Kukaj ne Puke, Diga e Babices ne Vlore, Diga e Kallmetit ne Lezhe, Diga e Dardhes ne Gramsh, Diga e Kabashit ne Kolonje, Diga e Seferajt ne Kavaje, Diga e Corrushit ne Mallakaster dhe Diga e Libofshes ne Fier

Njëkohësisht, sipas nje inspektimi nga KKDM rezulton se afro 10 % e digave te medha dhe me se 25 % e digave te vogla nuk përdoren per qellimin qe jane projektuar dhe ndertuar, për arsye se kanë dalë jashtë funksionit. Gjithashtu, disa bashki që janë shfrytëzuese të këtyre digave kanë kërkuar nxjerrjen jashtë funksionit të disa digave të mëdha të administruara prej tyre por pa paraqitur ndonjë projekt apo plan braktisje apo miratim nga Ministria përkatëse. KKDM sugjeron dhe kërkon rivlerësim teknik nga specialistë me eksperiencë në këtë fushë dhe të liçencuar të cilët të hartojnë projektin dhe raportin e duhur në përputhje me standartet teknike shqiptare, legjislacionin ne fuqi dhe rekomandimet e ICOLD.

Gjatë vitit 2024 duke u bazuar në komunikimin me shfrytëzuesit e digave dhe disa inspektimeve në terren, na rezulton se në mëse 85 % të digave të mëdha të vendit, ka mungesë të rregulloreve të shfrytëzimit të digave, mungese te monitorimit te sasise se ujit qe ndodhet ne rezervuar, mungesë të matjeve të volumeve aktuale të ujit dhe te sedimenteve në rezervuarët e krijuar nga këto diga sipas kerkesave te nenit 30 te VKM perkatese. Keto mungesa ndikojne ne administrimin dhe perdorimin jo efikas te ujit te grumbulluar ne keto rezervuare.

Nje problem qe nuk po gjen akoma zgjidhje eshte mungesa e planeve të gadishmërisë në rastet e emergjencave civile (PGEC) dhe mungesa e sistemeve te alarmit. Ne me se 90 % te digave te medha mungojnë sistemet e alarmit, hartat e permbytjeve ne zonat urbane poshte tyre dhe PGEC në përputhje me standartet bashkëkohore dhe kërkesat e KKDM. Kjo ceshtje behet me problematike ne afro 65 digat me rrisk ekstrem dhe te larte per humbje jete te njerezve te identifikuara nga KKDM dhe te dhena ne Shtojcen 3 te ketij Raporti.

Gjithashtu, në realitetin e shfrytëzimit të digave te medha nga disa kompani koncesionare te prodhimit te energjise ujore përmes HEC-eve, të cilët janë shfrytëzues të ketyre digave, ka shumë raste të mos respektimit të kërkesave të legjislacionit të sipërcituar. Shume prej ketyre shfrytëzuesve nuk kane instaluar sisteme te monitorimit te digave dhe sisteme te alarmit. Disa prej tyre si shfrytëzuesit e diges se HEC Lumzi, diges se HEC Belisoves apo diges se HEC Helmes jo vetem qe nuk kane kryejne monitorimin e ketyre digave sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi por nuk kane dorezuar edhe raportet vjetore per vitin 2024 te kerkuara nga KKDM dhe ligji i mesiperm.

Për të dhënë një pasqyrë më të detajuar të gjendjes, monitorimit dhe sigurise se digave si dhe masat qe jane marre nga shfrytëzuesit e digave ne kete drejtim, KKDM ka pregatitur me poshte nje informacion te holleishem per problematikat ne digat kryesore sipas qellimit te shfrytëzimit dhe Administratoreve/ Pronareve te tyre.

3.1 - Digat e mëdha që përdoren për prodhim energjie ujore

Sipas regjistrimit të KKDM, në vendin tonë aktualisht janë **28 diga të mëdha** që përdoren për prodhim të energjisë ujore nga të cilat 6 diga të mëdha janë pjesë e Kaskadës së lumit Drinit të shfrytëzuara nga KESH, 2 diga janë pjesë e kaskadës së lumit Devoll që shfrytëzohen nga Shoqëria DEVOLLI HP (Moglicë dhe Banjë), 3 diga janë pjesë e kaskadës së lumenjve Mat dhe Fan të shfrytëzuara nga kompanitë AYEN, KURUM. Gjithahstu, në këtë grup përfshihen edhe disa diga të mëdha që shfrytëzohen nga Koncesionare në deget e lumenjve kryesore të vendit siç janë diga e Okshtunit, Diga e Osojes, Diga e Murdharit, diga e Lumzit, etj. Në këtë grup bëjnë pjesë edhe disa diga që janë ndërtuar për qëllime ujëtare por pas viteve 2000, me anë të dhënies me koncesion përdoren për prodhim energjie. Në këtë grup përfshihen digat e Gjancit në Korce, Diga e Belesoves në Berat, Diga e Helmesit në Kolonjë dhe diga e Liqenit të Zi në Diber.

- **Digat e mëdha për prodhim energjie të kaskadës së lumit Drin të administruara nga KESH sh.a.**

Kontrolli, monitorimi dhe siguria e 6 digave të mëdha në kaskadën e lumit Drin kryhet nga ekipe teknike sipas rregulloreve përkatëse të shfrytëzimit. KESH jo vetëm kryen një kontroll vizual sipas kërkesave teknike por ka instaluar në çdo digë sistemet bashkëkohore përkatëse të monitorimit të digës dhe të rezervuarëve.

Në vitin 2015, KESH ka përgatitur edhe hartat e përmbajtjeve për zonën poshtë digave në rastet e prurjeve që mund të vijnë një herë në 20 vjet, një herë në 50 vjet dhe një herë në 100 vjet. KKDM sugjeron se kjo harta duhet të përditesohet duke u bazuar në matjet e sipërfaqes së tokës në këtë zonë, zhvillimet aktual urban të zonës poshtë digave deri në bregdetin Adriatik, kapaciteteve ekzistuese të shkarkimit në çdo digë, kushteve të reja të shfrytëzimit të kaskadës së lumit Drin duke përfshirë edhe shfrytëzimin nga HEC Ashta si dhe kombinimet të prurjeve që vijnë nga lumi i Bunës dhe shkarkimet që kryhen nga digat e Qyrësaqit dhe Zadejes të HEC Vau i Dejës.

Bazuar në studimet e mëparshme, në 2 matjet e fundit të volumeve të ujit në të 3 ujëmbledhësit e krijuar, në kushtet e shfrytëzimit aktual të kaskadës së lumit Drin nga KESH si dhe në grumbullimin e të dhënave të shumta të monitorimit gjatë 40 viteve të fundit në lidhje me prurjet dhe rreshjet në pellgun ujëmbledhës të lumit Drin, menaxhimin e integruar të ujërave të kaskadës si dhe problematikat që janë hasura nga përmbajtjet në vitet 2010 dhe 2018, KKDM sugjeron që **KESH duhet të ndërmarrë inisiativë** të bazuar në ekspertizë të thelluar, profesionale dhe të studjuara për përditesimin dhe përmirësimin e menaxhimit të integruar të Kaskadës së lumit Drin dhe ngritjen në një stad bashkëkohor dhe eficient të menaxhimit të prurjeve të mëdha në kaskadën e lumit Drin. Kjo ekspertizë mund të mbështetet në Udhëzimet dhe rekomandimet e dhëna nga KKDM si dhe në buletinet e ICOLD Nr. 186 “Për menaxhimin e integruar të digave të kaskadës”, Nr. 187 “Për menaxhimin e rrezikut dhe përmbajtjeve”, etj.

KESH vazhdon të operojë me rregulloren e hartuar nga grupi i projektimit në vitin 1988 për shfrytëzimin e digave dhe shkarkimeve në rastet e plotave të mëdha. Nga shqyrtimi i të dhënave të niveleve të ujit në të tre rezervuarët e kaskadës së lumit Drin gjatë 10 viteve të fundit, rezulton se në disa raste kjo rregullore nuk është respektuar në lidhje me menaxhimin dhe shkarkimin e prurjeve maksimale gjatë periudhës ujeshume në dimër dhe në pranverë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

Duke u bazuar në të gjitha të dhënat dhe studimet e deri sotme të kryera nga KESH, **KKDM rekomandon kryerjen e një rishikim të plote dhe përditësimi nga ekspertë me përvojë të Rregullores së Shkarkimit të Plotave në kaskadën e lumit Drin** e hartuar në vitin 1988 nga specialistet e ISP Nr.3 duke e përshtatur me kushtet dhe metodat e sotme të menaxhimit të integruar të kaskadave, të dhenave dhe kushteve aktuale të monitorimit si dhe ndryshimeve klimatike në vendin tonë.

Rishikimi i rregullores duhet të ketë si fokus rritjen e sigurisë së digave të kaskadës së lumit Drin, operimin optimal të integruar të ujëmbledhësave të kaskadës si dhe përgatitjen e moduleve të operimit duke kombinuar përfitimet nga hidroenergja me zvogëlimin e rriskut nga përmbytjet dhe përfitimet për kulturat bujqësore në tokat që ndodhen në zonat poshtë digave të HEC Vau i Dejës. Ky rishikim duhet të marrë në konsideratë edhe konkluzionet e dhëna nga ekspertet e huaj për rritjen e kapaciteteve të shkarkuesve në digat e HEC Fierzë dhe HEC Koman si dhe volumet aktuale të ujit në 3 rezervuarët e kaskadës së lumit Drin.

Në kuadër të një shfrytëzimi të integruar të ujërave në kaskadën e lumit Drin, KKDM rekomandon ngritjen dhe funksionimin e Komisioneve Ndërkufitare të ujërave me Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe me Kosovën për të bërë të mundur jo vetëm shfrytëzimin e përbashkët të ujërave të basenit ujëmbledhës të lumit Drin por edhe për të krijuar një bashkëpunim institucional ndërqeveritar në lidhje me monitorimin dhe sigurinë e digave të kaskadës së lumit Drin si dhe zvogëlimin e efekteve të përmbytjeve në zonën e nënshkodres.

Theksojmë se kaskada e Lumit Drin për vetë tipin e digave të ndërtuara, kompozicionin dhe basenet e krijuara, kapacitetet e instaluar të energjisë, dinamikën e përdorimit për shfrytëzimin e kësaj energjie, peshën specifike në prodhimin e energjisë dhe impaktin pozitiv në ekonomine e vendit është Unikë në Europë. Gjithashtu, duke patur parasysh edhe faktin e Rrezikut të lartë njerezor, social dhe ekonomik në raste të ndonjë dëmtimi të mundshëm natyror, **KKDM kërkon që kjo kaskadë të marrë statusin e veprave strategjike të rëndësishme shumë të veçantë** e cila duhet të shoqërohet edhe me të gjitha masat organizative e teknike përkatëse dhe ekip të veçantë e të kualifikuar për monitorimin dhe analizën e të dhënave të monitorimit të marra online në kohë reale për të gjitha digat e kaskadës.

Referuar studimeve, analizave dhe matjeve të kryera në vitin 2015 dhe 2023, kapaciteti total i ujëmbledhësit të Fierzës deri në nivelin maksimal të operimit 296.00 mmnd, rezulton të jetë rreth 2.3 miliard m³ ujë, 15 % më pak se volumi i ujit prej 2.7 miliard m³ i dhënë në fazën e projektimit të veprës. Zvogëlimi të volumit të ujit në masën 10-15 % janë evidentuar edhe në matjet për rezervuarët e HEC Koman dhe HEC Vau i Dejës. Bazuar në keto matje, **volumi i ujit në të tre rezervuarët e krijuar të kaskadës së lumit Drin ka zbritur në 3.3 miliard m³ ujë.** Për sa me sipër është e domosdoshme reflektimi i të dhënave të këtyre matjeve në operimin dhe shfrytëzimin e kaskadës së lumit Drin

Nga Raporti vjetor i KESH si dhe nga kontrollët e kryera në terren, një problem që duhet të monitorohet me kujdes të vazhdueshëm në kohë reale dhe në mënyrë online, vazhdojnë të jenë **filtrimet në biefin e poshtëm të digës së Komanit**, vlerat e të cilave prej më se 800 l/sek janë shumë më të larta se vlerat e rekomanduara nga literatura ndërkombetare dhe rekomandimet e ICOLD. Gjatë vitit 2024, sistemi i monitorimit të këtyre filtrimeve ka qenë i demtuar për shkak të shkarkimeve të kryera nga Shkarkuesi Nr. 3 dhe Nr. 4, të hapur njëkohsisht.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM ka kërkuar që procesi i kontrollit dhe monitorimit të sasisë së ujrave që filtrojnë në anën e poshtme të digës së HEC Koman si dhe turbullësia e tyre në kohë të ndryshme, duhet të kryhet në vijimesi, në kohë reale dhe të dhënat e monitorimit të tyre duhet të analizohen nga eksperte me përvojë në këtë fushë. KESH duhet të marrë masat e duhura për rehabilitimin e strukturës hidraulike për monitorimin e këtyre filtrimeve të dëmtuar gjatë shkarkimeve të vitit 2022 e cila vazhdon të jetë jashtë funksionit.

Gjithashtu, KKDM sugjeron që KESH të kryejë studime më të detajuara dhe të thelluara me metoda bashkëkohore siç janë metoda e analizës elektromanjetike për përcaktimin e rrugëve të lëvizjes së ujrave nentokesore nga liqeni përmes digës së HEC Koman në drejtim të anës së poshtme të saj.

Duhet përmendur fakti që përpara sezonit të rreshjeve, në muajt Shtator -Tetor 2024, KESH ka kryer testimet e funksionimit të sistemeve të shkarkimit në të tre HEC-et e Kaskadës së lumit Drin të cilat kanë rezultuar të suksesshme. Mbetet problem mosfunksionimi prej shumë vitesh i shkarkuesit fundor në digën e Qyrësaqit të HEC Vau i Dejes ku janë konstatuar edhe filtrime nga portat e shkarkimit në një masë prej afro 1000 l/sek.

Duhet theksuar se edhe gjatë vitit 2024, KESH ka kryer investime të mëdha për përmirësimin e monitorimit të digave, rritjen e sigurisë së veprave kryesore të tyre në përgjithësi si dhe për operimin e sigurtë të tyre gjatë prurjeve të mëdha.

Gjithashtu, në të gjitha digat e kaskadës së lumit Drin janë instaluar sistemet e alarmit dhe janë përgatitur Planet e gadishmerisë në rastet e emergjencave civile por KKDM ka kërkuar që KESH në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC) duhet të kryejë testimet e funksionimit të këtyre sistemeve

KKDM ndjek me vëmendje investimet e kryera me financim të Bankës Botërore dhe KfW për të cilat ka kërkuar të mbikqyren dhe të kollaudojnë sipas kërkesave të ligjit. KKDM ka kërkuar që dokumentacioni teknik i punimeve (sipas faktit) për punimet e kryera, duhet të dorëzohet në përputhje me kërkesat ligjore por deri më sot KESH nuk ju është përgjigjur këtyre kërkesave ligjore. KKDM është në pritje të përmbushjes së këtij detyrimi nga KESH sh.a.

○ **Digat e mëdha për prodhimin e energjisë të kaskadës së lumit Devoll të administruara nga Devolli HP/ Statcraft**

Kontrolli, Monitorimi dhe siguria e digave të HEC Banjë dhe HEC Moglicë kryhet nga ekipe teknike të kualifikuara dhe sipas rregulloreve përkatëse të shfrytëzimit. Kompania Devolli HP/Statcraft jo vetëm kryen një kontroll vizual sipas kërkesave teknike por ka instaluar në çdo digë sistemet bashkëkohore përkatëse të monitorimit.

Kompania Devolli HP/ Statcraft ka hartuar dhe miratuar rregulloret për shfrytëzimin e digave dhe shkarkimeve në rastet plotave të mëdha. Për të dy digat e mëdha që administrohen prej tyre, janë përgatitur Planet e Gadishmerisë në rastet e emergjencave civile të shoqëruar me skenaret sipas kërkesave të ligjit.

KKDM ka ndjekur me vëmendje kontrollin dhe monitorimin e digës së HEC Moglicës gjatë vitit 2024 si dhe ka analizuar rezultatet e dhëna në raportet teknike përkatëse të Shfrytëzuesit të digës.

KKDM ka kerkuar monitorim te kujdesshem dhe te thelluar të problematikave në lidhje me uljet në kuroren e digës së HEC Moglicës si dhe uljeve në pjesën e sipërme të trupit të digës te cilat po kryhen me seriozitet nga shfrytëzuesi i saj.

KKDM ka kërkuar vazhdimin e procesit të monitorimit të hollesishem si dhe të analizës së thelluar të këtyre problematikave. Në rastet se nga monitorimi i situatës vihen re përkeqësime, shfrytëzuesi i digës duhet të raportojë në kohë reale institucionet përkatëse.

○ **Digat e mëdhe për prodhime energjie në lumin Fan dhe Mat të shfrytëzuar nga AYEN, Kurum dhe Lumzi MC.**

Diga e HEC Ura e Fanit. Kontrolli, Monitorimi dhe siguria e digës së HEC Ura e Fanit kryhet nga ekipe teknike dhe sipas rregulloreve përkatëse të shfrytëzimit. Kompania AYEN jo vetëm kryen një kontroll vizual sipas kërkesave teknike por ka instaluar edhe instrumentat perkatese per monitorimin e diges. Ne baze te matjeve te kryera dhe kontrollit te kryer gjate vitit 2024, rezulton se ne kete dige ka probleme ne lidhje me filtrimet ne pjesen e poshtme te diges te cilat jane me te medha se vlerat e projektuara. Pas identifikimit te ketij problem, KKDM i ka kerkuar kompanise AYEN jo vetem te monitoroj keto filtrime por te marre masat e duhura per rehabilitimin e sistemit te monotorimit te tyre si dhe instalimin e pajisjeve dhe instrumentave per monitorim online dhe real te tyre. Deri me sot, Keto instrumenta nuk jane vendosur.

Kompania AYEN ka hartuar rregulloret për shfrytëzimin e digës dhe shkarkimeve në rastet e plotave të mëdha e cila është aprovuar nga KKDM. Shfrytëzuesi i digës ka përgatitur hartat e përmbytjeve dhe Planet e Gadishmërisë në rastet e emergjencave civile të shoqëruara me skenarët sipas kërkesave të ligjit dhe duke u bazuar në gjendjen faktike të diges.

Diga e HEC Ulez dhe HEC Shkopet. Kontrolli, monitorimi dhe siguria e digës së HEC Ulzës dhe HEC Shkopetit kryhet nga ekipe teknike të kualifikuara dhe sipas rregulloreve përkatëse të shfrytëzimit. Kompania KURUM jo vetëm kryen një kontroll vizual sipas kërkesave teknike por ka instaluar edhe sisteme të monitorimit të digës të cilat funksionojnë dhe japin të dhëna të rregullta. KURUM ka hartuar rregulloren për shfrytëzimin e digës dhe shkarkimeve ne rastet e plotave të mëdha e cila është shqyrtuar në KKDM. Planet e Gadishmërisë në rastet e emergjencave civile për digat e Ulzës dhe Shkopetit, janë përditësuar duke marrë në konsideratë plotësimet dhe ndërhyrjet e kryera në digën e HEC Ulzës në vitin 2018.

Te dy shfrytezuesve te digave te mesiperme, ju eshte kerkuar qe te kryejne edhe Analiza ne lidhje me shfrytezimin e prurjeve ne rezervuaret e krjuar nga digat duke i krahasuar edhe me te dhenat hidro-meteorlogjike te projektit per rastet e perseritjes se prurjeve 1 here ne 100 vjet dhe nje here ne 1000 vjet

Diga e HEC Lumzi. Kontrolli, monitorimi dhe siguria e digës së HEC Lumzi nuk kryhet nga ekipe teknike të kualifikuara dhe sipas rregulloreve përkatëse të shfrytëzimit. **Kompania MC Inerte Lumzi jo vetëm që nuk kryen kontroll dhe monitorim me instrumenta sipas kërkesave teknike, por deri më sot nuk ka dorëzuar ndonjë Raport Vjetor në lidhje me gjendjen e digës apo monitorimin e saj. Në digën e HEC Lumzi nuk ka të instaluar sisteme të monitorimit të digës apo sisteme te alarmit.**

- **Digat e mëdha për prodhim energjie të administruara nga disa koncesionarë të tjerë.**

Bazuar në kontrollet e kryera nga strukturat e KKDM dhe raportimet e kërkuara nga shfrytëzuesit e digave, rezulton se **kontrolli, mirëmbajtja dhe monitorimi i digave të HEC Helmes, Belesovë, Gjanc, etj nuk kryhen sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, udhezimeve të KKDM dhe rekomandimeve të ICOLD. Ato kryejnë vetëm kontrole vizuale dhe nuk kane nje baze te dhenash te matjeve te monitorimit me ane te instrumentave sipas kërkesave teknike. Asnjë prej shfrytëzuesve të mësipërme, nuk kanë dorezuar prane KKDM ndonjë rregullore për shfrytëzimin e digës dhe shkarkimeve në rastet plotave të mëdha apo rregullore per monitorimin e diges dhe rezervuarit.** Ne asnje prej ketyre digave nuk ka te instaluar sisteme te alarmit. KKDM ka kërkuar zyrtarisht plotësimin e saj me hartat e përmbajtjeve në zonën poshtë digës, llogaritjen e valës shkatërruese, matjet batimetrike për volumin e ujit në rezervuar, Pregatitjen e planeve të gadishmërisë në rastet e emergjencave civile sipas legjislacionit në fuqi të shoqëruar me skenarët sipas kërkesave të ligjit. Të gjitha këto kërkesa nuk janë plotësuar akoma nga këta shfrytëzues dhe mungesa e nje ekipi te plote te ITD e bën të pamundur zbatimin e sanksioneve të përcaktuara në legjislacionin përkatës.

3.2 - Digat e mëdha që perdoren për Furnizim me Ujë (Diga e Bovillës dhe e Manskurisë)

Sipas rregjistrimit të KKDM, në vendin tonë aktualisht janë dy diga të mëdha që përdoren për furnizimin me ujë të popullsisë urbane në bashkinë e Tiranës, Kamzes dhe Kavajes. Diga më e rëndësishme në këtë grup është diga e Bovillës me lartësi 91 m që përdoret për furnizimin me ujë të qytetit të Tiranës dhe të Kamzes.

Kontrolli, Monitorimi dhe siguria e digës së Bovillës kryhet nga ekip teknik I UKT sipas rregulloreve përkatëse të shfrytëzimit. Bazuar në Kontrollin e kryer nga KKDM si dhe në korrespondencën e gjatë të KKDM në lidhje me problematikat e hasura ndër vite për shfrytëzimin dhe monitorimin e digës së Bovillës, rezulton se Diga e Bovillës nuk monitorohet sipas kërkesave të legjislacionit për Digat dhe nuk ka nje sistem alarmi per rastet e emergjencave civile sic kerkohet ne legjislacionin perkates. KKDM i ka kërkuar UKT dhe Bashkisë Tiranë marrjen e masave thelbësore për monitorimin dhe sigurinë e kësaj dige edhe për vetë faktin që kjo digë është objekt i rëndësisë së veçantë. Per kete dige, vazhdon te jete problem jo vetem mungesa e monitorimit te diges por edhe grumbullimi dhe perpunimi I te dhenave te monitorimit si dhe monitorimi i një masivi rrëshqitës në anën e djathtë të rezervuarit. Nje problem I identifikuar ne dhjetor te vitit 2024 eshte fillimi I disa punimeve per hapjen e nje rruge kembesore mbi shkarkuesin katastrofik nga Bashkia Tirane, pe rte cilin KKDM ka kerkuar nderprerjen e menjehershme te punimeve dhe kthimin ne origjinalitet por deri me sot, nuk ka asnje pergjigje nga Bashkia e Tirane. Gjithahstu, Theksojme se mungesa e nje sistemi alarmi krijon probleme per sigurine e me se 100 000 njerezve qe jetojne ne zonat urbane poshte kesaj dige te cilet jane ne rrezik ne rast te prishjes se diges apo prurjeve e medha.

Gjithashtu, çëhtje që kërkon vemendje dhe analize të thelluar është edhe procesi i sedimenteve në rezervuarin e kësaj dige si dhe disa aktiviteteve të shoqruara me shperthime eksplozioni ne afersi te diges nga kompani qe shfrytezojne karrierat per prodhim guri ne afersi te saj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

Kontrolli, mirëmbajtja dhe monitorimi i digës së Manskurisë aktualisht kryhet nga ndermarrja rajonale UK Durrës, pas reformës në sektorin e furnizimit me ujë dhe bashkimit të ndermarrjeve të UK Kavajë dhe UK Durrës. Në këtë digë janë kryer inspektime në bashkepunim me drejtuesit e UK Durrës dhe janë konstatuar defekte të rënda dhe problematika të mëdha në trupin e digës. Kjo digë dhe rezervuari i krijuar prej saj aktualisht janë jashtë funksionit dhe aktualisht mbahen në gjendje alarmi duke mbajtur nivele minimale të rezervuarit dhe duke mos e përdorur për furnizim me ujë të zonës. Gjatë vitit 2024, UK Durrës dhe AKUM kanë përgatitur një projekt zbatimi për rehabilitimin e digës së Manskurisë I cili është shqyrtuar në KKDM dhe është vendosur të bëhen disa plotësime dhe rregullime të projektit. Zbatimi I projektit të plotësuar sipas kërkesave të KKDM, mendohet të japë zgjidhje problematikave të konstatuara. Aktualisht, në këtë digë nuk ka të instaluar sisteme monitorimi apo sisteme alarmi dhe UK Durrës kryen vetëm kontrolle vizuale të gjendjes së digës. Në projektin e zbatimit janë parashikuar instalimi i sistemeve të monitorimit në digë.

3.3 - Digat e mëdha që përdoren kryesisht për Ujitje dhe peshkim dhe që administrohen nga MBZHR,

Sipas rregjistrimit të KKDM, në vendin tonë aktualisht janë 8 diga të mëdha që përdoren për ujitje dhe peshkim të cilat shfrytëzohen nga MBZHR. 2 prej këtyre digave janë dhënë me koncesion për prodhim hidroenergjie tek kompani private (Diga e HEC Gjancit në Korce dhe Diga e Belesoves në Berat). Gjithashtu, kompleksi hidroteknik i Ashtes që administrohet nga bordi i kullimit të Lezhës në varësi të MBZHR është përcaktuar si digë e madhe me vendim të KKDM për arsye se përmbush kërkesat e pikës b dhe c të nenit 3 të ligjit Nr. 8681. Ky kompleks është përbërë nga një argjinaturë mbrojtëse me gjatësi mbi 2.6 km që krijon një rezervuar uji me volum mbi 2 milion m³ në zonën ndërmjet digave të HEC Vau i Dejës dhe kësaj argjinature, veprën e shkarkimit të ujrave të tepërta dhe sistemin e marrjes së ujit për ujitjen e zonës së tokave bujqësore të Vaut të Dejës. Për gjendjen e këtij kompleksi si dhe monitorimin e tij, deri më sot, nuk ka asnjë raport apo informacion nga MBZHR në lidhje me rezultatet e kontrollit të këtij kompleksi megjithatë kërkesat e KKDM dhe problematikat e evidentuara në terren.

Kontrolli, mirëmbajtja, monitorimi dhe siguria e digave të mëdha që administrohen nga MBZHR, kryhet nga ekipe teknike të 4 bordeve të kullimit të MBZHR që ndodhen në Fier, Durrës, Korcë dhe Lezhë. Këto ekipe kryejnë vetëm kontrolle vizuale sipas disa udhëzimeve teknike të hartuar nga MBZHR shumë vite më parë por nuk kryejnë monitorim me instrumenta të digave siç kërkohet në VKM Nr. 147, neni 31 dhe 32. Në kuadër të projektit të financuar nga BB, janë instaluar instrumenta të monitorimit të digave në 4 prej këtyre digave, por akoma nuk është hartuar ndonjë program i veçantë për mirëmbajtjen dhe monitorimin e tyre nga bordet e kullimit të MBZHR. Deri më sot bordet e kullimit që i administrojnë këto diga dhe MBZHR si Ministri përgjegjës për përdorimin, mirëmbajtjen dhe monitorimin e këtyre digave, nuk kanë asnjë bazë të dhënash të monitorimit të tyre. Të gjitha digat e mëdha që përdoren dhe administrohen nga kjo Ministri, nuk kanë të instaluar sistemet e alarmit dhe nuk kanë përgatitur dhe miratuar ndonjë plan të gadishmerisë në rastet e emergjencave civile duke qenë në shkelje të kërkesave ligjore në fuqi të përmendura më sipër.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

Bazuar në Raportin vjetor të MBZHR dhe kontrollet e ushtruara në terren nga KKDM në lidhje me problematikat e hasura gjatë shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes të digave të Ujitjes të administruara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), deshirojme tju informojme se:

- **Mungojnë sistemet e alarmit në të gjitha digat e medha që administrohen nga bordet e kullimit të MBZHR.**
- **Mungojnë Planet e Gadishmërisë në rastet e emergjencave civile** për të gjitha digat që janë nën administrimin e MBZHR. Në zbatim të Ligjit Nr. 45, datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen Civile” dhe VKM nr. 147, datë 18.03.2004 “Rregullore për Sigurinë e Digave dhe Dambave” kerkohet hartimi i ketyre planeve nga shfrytëzuesit e digave dhe miratimi i tyre nga KKDM. Deri me sot, megjithë kërkesat e përsëritura të KKDM si dhe kërkesat ligjore për hartimin e planit të gadishmërisë në rastet e emergjencave civile për digat që shfrytëzohen nga kjo Ministri, akoma nuk është dërguar ndonjë dokument i tillë pranë KKDM për miratim. MBZHR duhet të hartoj urgjent planet e alarmit dhe të evakuimit duke përfshirë edhe studimin për përhapjen e vales shkatërruese në luginën poshtë diges sipas kërkesave teknike si dhe planin e gadishmërisë në rastet e emergjencave civile.
- **Mungojnë monitorimi me instrumenta i digave të medha si dhe sistemi i grumbullimit dhe perpunimit të të dhënave të matjeve të monitorimit sipas kërkesave teknike dhe ligjore si dhe udhëzimeve të KKDM** për të gjitha llojet e monitorimit të diges sic janë monitorimi gjeologjik, gjedoezik, hidraulik dhe hidrometeorologjik në lidhje me uljet e mundshme të diges, filtrimet e ujrave, rrëshqitjet, lëvizjet lokale në trupin e digave dhe në shpatet e tyre. Theksojmë se njohja e fenomeneve që ndodhin në diga si dhe të gjëndjes së tyre shërben jo vetëm për rritjen e sigurisë së digave por edhe për analizimin e problematikave që mund të kenë ndodhur gjatë viteve të operimit dhe shfrytëzimit të saj. Kjo lidhet edhe me faktin e moshës së vjetër të ndërtimit të këtyre digave shumica e të cilave janë ndërtuar me shumë se 50 vite. Problematika behet me e madhe duke u nisur edhe nga fakti i mungesës së mirëmbajtjes dhe monitorimit të tyre si dhe nga fakti i popullimit të zonës urbane poshtë tyre.
- **Mungojnë matjet dhe analiza e sedimenteve në rezervuaret e krijuar** nga këto diga dhe kryerja e matjeve batimetrike të volumeve të ujëmbledhësit. Megjithatë sipas VKM Nr. 147, datë 18.03.2004, neni 30, këto matje duhet të bëhen të paktën një herë në 5 vjet, deri më sot këto matje dhe analiza nuk janë kryer asnjëherë në shumicën e digave të medha që administrohen nga kjo Ministri. Problemi behet me i mprehtë duke patur parasysh faktin se këto diga janë ndërtuar para me shumë se 50 vitesh dhe fenomeni i mbushjes me sedimente është mjaft i dukshëm për të cilin kerkohet një analizë dhe konkluzione sa më të shpejta për të analizuar jo vetëm jetegjatesinë e tyre por edhe masat që duhet të merren në të ardhmen për menaxhimin e integruar të ujrave të tyre.
- **Mungon një monitorimi bashkëkohor i prurjeve dhe niveleve të ujit** në rezervuaret e krijuar nga këto diga e cila krijon probleme të medha për administrimin e sasisë së ujit në këto rezervuare gjatë sezonit të ujitjes. Shembull tipik të një keqadministrimi të ujit për ujitje mund të përmendet përdorimi i ujit në rezervuarin e Thanës i cili është rezervuari më i madh për ujitje në vendin tone

Për sa më sipër, KKDM ka kërkuar disa herë marrjen e masave përkatese për zgjidhjen e problematikave të mësipërme të shoqëruara me një program të detajuar pune për realizimin e këtyre masave të kërkuara me sipër në përputhje me legjislacionin në fuqi. Deri më sot, nuk ka një përgjigje pozitive dhe anagzhim serioz nga ana e MBZHR për rregullimin e gjendjes.

3.4 - Digat e mëdha që përdoren për Ujitje dhe peshkim nga pushtetet lokale,

Sipas regjistrimit të KKDM, në vendin tonë aktualisht janë 322 diga të mëdha që përdoren për ujitje dhe për peshkim. Keto diga shfrytëzohen nga 55 bashki që i kanë marrë në administrim përmes VKM Nr. 1108, datë 30.12.2015. Ne shumicën e këtyre digave si dhe tek digat e vogla ka mjaft probleme në lidhje me gjendjen e tyre, dokumentacionin teknik, monitorimin dhe sigurinë e zonave urbane poshte këtyre digave.

Në të gjitha digat e mëdha që përdoren për ujitje nga bashkitë e vendit nuk ka të instaluar sisteme alarmi duke qenë në shkelje të kërkesave ligjore në fuqi. Në këto diga nuk ka ndërtesë të shërbimit dhe ruajtjes së digë siç kërkohet në VKM Nr. 147, neni 29.

Per sa më sipër, **KKDM rekomandon që inspektimi për gjendjen e digave të mëdha që përdoren për ujitje dhe peshkim si dhe për përgatitjen e dokumentacionit teknik të tyre dhe të Planeve të Gadishmerise në rastet e Emergjencave Civile, mund të kryhet nepermjet nje projekti të financuar nga MBZHR ose AKMC me specialistë të licencuar dhe me pervoje në sektorin e digave të mëdha duke u bazuar në kërkesat e legjislacionit në fuqi për digat si dhe aktet e tjera nënligjore.**

Bazuar në legjislacionin në fuqi, shfrytëzuesit e digave në bashkëpunim me Ministrinë e linjes dhe ITD, çdo 10 vjet duhet të kryejë kontrollin teknik të digave. Ky kontroll deri më sot nuk është kryer.

3.5 - Digat e mëdha për ujitje dhe zhvillim urban të shfrytëzuara nga Bashkia e Tiranës.

Bashkia e Tiranës është përdoruesi më i madh i digave të ujitjes, peshkimit dhe për zhvillimin urban të zonës duke patur nën administrim **38 diga të mëdha** (Diga e liqenit artificial të Tiranës dhe e Bovillës administrohet nga UKT).

Kontrolli, monitorimi dhe siguria e këtyre digave kryhet nga një sektor teknik i Bashkisë Tiranë. Këto ekipe kryejnë vetëm kontrole vizual por **në asnjë digë që përdoret nga kjo Bashki, nuk ka të instaluar instrumenta të monitorimit të digave apo sisteme alarmi siç kërkohet në VKM nr. 147, neni 31 dhe 32.**

Nga kontrollat e ushtruara në terren nga Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në lidhje me problematikat e hasura gjatë shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe monitorimit të digave të mëdha të shfrytëzuara nga Bashkia Tiranë vërehet se:

- **Në shumicën e digave të mëdha mungojnë hartat e permbytjeve në rastet e prurjeve të mëdha apo prishjes së mundshme të digave si dhe Planet e gadishmerise në rastet e emergjencave civile.** Duke patur parasysh popullimin e zonave urbane poshte digave si dhe rrezikun e demtimeve apo humbjeve të njerezve në rastet e demtimeve dhe prishjeve të këtyre digave, është e domosdoshme dhe urgjente përgatitja e tyre.
- **Mungojnë sistemet e alarmit në trupin e digave apo sistemet e lajmerimit të termeteve.** Duke patur parasysh ndertimet e shumta në zonën poshte digave si dhe numrin e madh të njerezve në rrezik që banojnë poshte tyre, instalimi i sistemeve të tilla moderne është një domosdoshmëri urgjente dhe ligjore.

- **Mungojnë instrumentat për matjet dhe monitorimin e digave sipas standarteve teknike, kerkesave te nenit 32 te VKM perkatese si dhe përpunimi i të dhënave të monitorimit ndër vite.**
- **Mungojnë matjet dhe analiza e sedimenteve në rezervuarët e krijuar nga këto diga dhe kryerja e matjeve batimetrike të volumeve të rezervuareve të krijuar nga këto diga sipas kerkesave te nenit 30 te VKM perkatese.**
- **Nuk ka asnjë vleresim te asetave dhe rregjistrim ne kadaster per digat dhe rezervuaret qe shfrytezohen nga bashkia Tirane**

Nder digat me problematike ne bashkine e Tiranës qe jane identifikuar edhe ne Raportin vjetor te kesaj bashkie jane diga e Shishtufines e cila eshte jasht funksionit per shkak te rreshqitjes ne trupin e diges, diga e Fjolles ku jane demtuar ujeleshuesi dhe shkarkuesi katastrofik, diga e Zelaj, diga e Skoranes e cila eshte e mbushur me sedimente dhe eshte jasht pune si dhe diga e Xingere ku ujeleshuesi eshte I bllokuar qe prej me se 10 vitesh.

Një prej digave me problematike qe shfrytezohe nga Bashkia e Tiranës dhe administrohet nga Ndermarrja UK Tirana, **është diga e liqenit artificial te Tirane**. Ne kete dige nuk ka te instaluar asnje instrument per monitorimin e diges dhe asnje sistem alarmi megjithese ne zonen poshte saj banojne afro 45 000 banore qe mund te jene ne rrisk ne rast te prishjes se diges apo permbytjeve qe mund te shkaktohen nga rreshjet e medha dhe mosfunksionimi I sistemit te shkarkimit. Ka me se 22 vjet qe portat e shkarkimit jane bllokuar dhe kane mbyllur hyrjen ballore te sistemit te shkarkimit te ujrave. Megjithë kërkesat e herepashershme dhe shqetesimin e ngritur ne bashkine e Tirane, Prefektura e qarkut Tirane dhe ne UKT, problemet e mesiperme vazhdojne te jene potenciale dhe shqetesuese

Për sa më sipër, KKDM ka kërkuar disa here marrjen e masave përkatëse për zgjidhjen e problematikave të mësipërme të shoqëruara me program pune për realizimin e këtyre masave në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjate vitit 2024, Bashkia Tirane ka pregatitur nje program pune per rehabilitimin e 14 digave te medha duke filluar edhe nje proces per hartimin e projekteve per rehabilitimin e tyre. Disa Projekte te hartuara nga kjo Bashki jane miratuar nga KKDM ndersa disa te tjera nuk jane miratuar per shkak te mosplotesimit te kerkesave te legjislacionit ne fuqi dhe standarteve teknike.

Nje problem qe eshte hasur gjate vitit 2024 eshte edhe mosplotësimi i kërkesave të ligjit në lidhje me miratimin e mbikqyresit të punimeve apo kolaudimin e punimeve të kryera nga Bashkia Tirane.

3.6 - Kontrolli shteteror i monitorimit dhe sigurise se digave te medha

Nje problem i pazgjidhur nga MIE vazhdon te jete mosfunksionimi i plote **Inspektoriatit Teknik të Digave (ITD), per te cilin eshte dhene nje zgjidhje e pjesshme nga MIE me emerimin e një specialisti**. Mungesat ne stafin e ITD ka krijuar probleme jo vetëm për kontrollin e gjendjes së digave apo punimeve të kryera në to, por edhe për marrjen e masave dhe penaliteteve të kërkuara nga ligji në fuqi gjatë kontrollit të punimeve në terren si dhe kontrollit të dokumentacionit të kërkuar që duhet të jetë pranë shfrytëzuesit të digave.

Për rrjedhojë, **KKDM do të kërkonte një zgjidhje të shpejtë dhe një riorganizim të institucioneve ne varesi të MIE** e cila do të përmiresojë ndjeshëm kontrollin me cilësi të këtyre veprave që janë të një rëndësie të veçantë. MIE duhet të plotësojë edhe kërkesat e legjislacionit në fuqi me ngritjen e një grupi të sigurisë së digave dhe përcaktimin e Institucionit përgjegjës për kontrollin shtetëror në lidhje me sigurinë e digave që perdoren për prodhim hidroenergjie dhe për furnizim me ujë të pijshëm. KKDM do të rekomandonte si një zgjidhje të shpejtë dhenien e detyrave perkatese Agjencisë Kombëtare të Burimeve Ujore e cila monitoron të gjitha HEC me dige që janë dhënë me koncesion

Në të ardhmen, **KKDM sugjeron kryerjen e një reforme të thellë institucionale, organizative dhe ligjore në sektorin e digave.**

Deshirojme të informojmë se në vendet Europiane si Franca, Italia, Spanja, Greqia, Zvicra, etj për një kontroll të shtetit më të plotë, më efikas dhe të specializuar, janë krijuar **Autoritetet e Sigurisë së digave që veprojnë nën Ministrinë e Infrastruktura** ku punojnë specialistë hidroteknike, konstruktor, gjeolog, sizmolog, gjeodet, mjedis dhe kanë krijuar bazën e të dhënave të monitorimit të këtyre digave. Në shembullin e këtyre vendeve, Autoriteti i Sigurisë së Digave mund të jetë strukturë pranë Ministrisë së Infrastruktura dhe Energjitikës ose të krijohet si një agjenci e specializuar e pavarur e Këshillit të Ministrave siç është Enti rregullator i Ujit apo i Energjisë. Kjo reformë është mjaft e rëndësishme për vetë faktin se ky sektor jo vetëm që ka rëndësi të veçantë për ekonominë dhe sigurinë e vendit dhe të njerezve por edhe objektet e digave konsiderohen me ligj si objekte të rëndësise së vecante.

Bazuar në një analizë të kryer nga KKDM rezulton se legjislacioni i sigurisë së digave dhe struktura e kërkuar institucionale e sigurisë së digave në Shqipëri të përgatitura 20 vjet më parë nuk janë më të përshtatura me kushtet aktuale. Duke u bazuar në situatën aktuale të identifikuar gjatë kryerjes së kësaj analize KKDM **kërkon një rishikim të thellë të kuadrit institucional, organizativ dhe ligjor, me caktim të qartë dhe të zbatueshëm të roleve dhe përgjegjësisë ndërmjet aktorëve të ndryshëm dhe legjislacionit mbështetës.**

Me poshtë po japim në mënyrë të përmbledhur rekomandimet e KKDM për përmirësimin e këtij sektori si më poshtë:

1. Të rishikohet Ligji 8681, datë 02.11.2000 dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 147, 18.03.2004 për të mbështetur strukturën e rishikuar institucionale dhe konceptet e sigurisë së digave. Të qartësohen rolet, detyrat dhe të drejtat e të gjithë palëve të interesuara me kërkesa të qarta në lidhje me sigurinë gjatë operimit. Në këtë proces, të sigurohet fuqi e fortë zbatuese për Agjencinë Shtetërore të Sigurisë së Digave;

2. Përafrimi i strukturës institucionale të sigurisë së digave me praktikën ndërkombëtare dhe në mënyrë të vecante atë europiane, duke marrë parasysh realitetin vendas, duke përfunduar detyrat e Perdoruesit të digës si subjekt përgjegjës për respektimin e të gjitha kërkesave të sigurisë dhe të një Agjencie Shtetërore të Sigurisë së Digave e cila duhet të krijohet dhe të ketë detyra të qarta për kontrollin, monitorimin dhe zbatimin e sigurisë së digave;

3. Të ofrohen trajnime dhe burime teknike për sigurinë e digave për bashkitë dhe qeveritë vendore që zotërojnë dhe operojnë diga, mundësisht duke ngritur grupe teknike të sigurisë së digave nën drejtimin dhe administrimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në secilën prej Bashkive (pronarët e digave) ose me çdo mjet tjetër të përshtatshëm. Fillimi i mbikëqyrjes së duhur të sigurisë së digave në digat që nuk kanë të tilla;

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

4. Të kryhet një klasifikim i rrezikut të të gjitha digave të mëdha në vend si bazë për prioritizimin e kryerjes së inspektimeve 10-vjeçare, duke i dhënë prioritet përgatitjes së Planeve të Veprimit të Emergjencave si dhe identifikimin e digave të ujitjes që përbëjnë kërcënimin më të madh për popullatën;

5. Hartimi i një grupi udhëzimesh gjithëpërfshirëse për të ofruar udhëzime për të gjithë aktorët, në mënyrë më efektive duke iu referuar një grupi udhëzuesish ekzistues kombëtarë dhe duke i përshtatur ato me situatën dhe nevojat shqiptare;

8. Përgatitja e hartave të përmbytjeve për rastet e prishjeve të digave si dhe Planet e Veprimit Emergjent për të gjitha digat, duke përpunuar në mënyrë sekuenciale dhe duke filluar me ato që paraqesin kërcënimin më të madh për popullsinë në rast të thyerjes së digës; Ky proces të koordinohet me Agjencinë Kombëtare për Mbrojtjen Civile.

4. Programi dhe aktivitetet e KKDM gjatë vitit 2024.

KKDM ka zhvilluar një sërë aktivitete gjatë të gjithë vitit 2024 për promovimin e sektorit të digave, plotësimin e kërkesave të ligjit, rritjen e vëmendjes për monitorimin dhe sigurinë e digave, rritjen e bashkëpunimit me komitetet homologe europiane dhe botërore si dhe identifikimin e problematikave që kanë ndodhur në këtë sektor.

Në këto aktivitete kanë qenë të përfshira

- Organizimi i mbledhjeve të rregullta mujore gjatë të gjithë vitit nën drejtimin e Kryetarit të saj për të marrë vendime lidhur me të gjitha funksionet dhe detyrat e ngarkuara sipas legjislacionit në fuqi. Theksojmë se KKDM ka organizuar 8 mbledhje në 8 muaj të vitit gjatë periudhës Janar - Gusht 2024 ku janë marrë 20 Vendime të rëndësishme. Në 4 muajt e tjerë, nuk janë organizuar mbledhje për shkak të mungesës së konstituimit të antareve të rinj të KKDM nga MIE
- Inspektime dhe kontrolle në terren sëbashku me shfrytëzuesit e digave për të njohur me gjendjen aktuale të tyre, me monitorimin e digave dhe masat e marra për mirëmbajtjen dhe sigurinë e digave.
- Takime pune me shfrytëzuesit e digave dhe me Prefektët e Qarqeve kryesore të vendit për të shqyrtuar masat e marra në lidhje me planin e gadishmërisë për rastet e emergjencave civile si dhe me identifikimin e digave të mëdha që janë jashtë funksionit
- Organizimi i Simpoziumit ndërkombëtar me titull "Sfidat dhe Inovacione për digat me të mira" në bashkëpunim me Komitetin francez të digave CFBR, në Maj 2024
- Organizimi i aktiviteteve të ndryshme për nder të 60 vjetorit të antaresimit të Shqipërisë në ICOLD në Maj 2024 ku morën pjesë edhe Presidenti i ICOLD, prof. Michel Lino dhe zv.presidentja e ICOLD për Europën, zj. Lisa Bensasson
- Pjesëmarrje në Simpoziumin vjetor të CFBR në Francë në Janar 2024
- Organizimi i takimit me përfaqësues të 15 Autoriteteve Europiane të sigurojë se digave në Tiranë në Qershor 2024
- Pjesëmarrje në takime pune me përfaqësues të komiteteve të digave homologe si ITCOLD, POLCOLD, MACOLD, GRCOLD, CFBR.
- Organizimi i seminareve trajnuese me studente të Universiteteve Polis dhe Epoka për monitorimin e digave prej dheu

5. Përfundime dhe Rekomandime

Bazuar në analizen e mesipërme në lidhje me situatën aktuale në sektorin e digave të mëdha dhe dambave, KKDM ka evidentuar shumë problematika të këtij sektori të cilat deshiron të informoj Këshillin e Ministrave duke dhënë edhe rekomandimet përkatëse për zgjidhjet e tyre dhe përmirësimin në drejtim të kontrollit shtetëror për digat dhe dambat, monitorimin e digave dhe rezervuarëve nga shfrytëzuesit e digave, rritjen e sigurisë së digave dhe të zonave të banimit oshte tyre. Përfundimet dhe rekomandimet tona po i shtjellojmë më poshtë:

- ✧ **Situata në sektorin e digave të mëdha në lidhje me kontrollin, monitorimin dhe sigurinë e tyre është mjaft problematike. Për përmirësimin e kësaj situatë kërkohet një reformë e thellë institucionale, organizative dhe ligjore e sektorit dhe rritje të përgjegjësisë së shfrytëzuesve të digave përmes zbatimit të detyrimeve ligjore dhe ndërgjegjesimit të aktoreve që veprojnë në këtë sektor. Reforma duhet të mbështetet në sugjerimet e dhëna nga ekspertët e SECO në vitin 2023 si dhe në eksperiencën e vendeve të Komunitetit Europian në fushën e kontrollit, monitorimit dhe sigurisë së digave. Kjo reformë duhet të përqendrohet në ristrukturimin e sektorit të kontrollit shtetëror dhe menaxhimit të digave, në rishikimin dhe fuqizimin e kërkesave të legjislacionit në fuqi duke bërë të mundur rritjen e vëmendjes në këtë sektor dhe ushtrimin e një kontrolli vazhdueshëm dhe profesional. Është e domosdoshme të merret eksperiencë europiane e krijuar në vende me përvojë në këtë drejtim si Franca, Zvicra, Italia, Greqia, Anglia për ngritjen e një Autoriteti të Sigurisë së Digave të mëdha i cili të ketë detyra të qarta për kontrollin e shtetit mbi gjendjen e digave, monitorimin e tyre dhe miratimin e projekteve të ndërtimit të digave të reja dhe rehabilitimit të digave ekzistuese. Ky Autoritet mund të organizohet në strukturat e Ministrisë së Infrastruktës dhe Energjisë ose Ministrisë së Mjedisit. Në planin afatshkurter duhet të rishikohen dhe të përditësohet aktet ligjore dhe nënligjore në sektorin e digave të mëdha të cilat janë mjaft të vjetra dhe nuk i përgjigjen kushteve të zhvillimit dhe organizimit ekonomik të vendit.**
- ✧ **Shumica e digave të mëdha që përdoren për prodhim të energjisë ujore, janë në monitorim dhe mirëmbahen në mënyrë të rregullt. Problematike vazhdon të jetë monitorimi i disa digave të mëdha për prodhim energjie që administrohen me konçesion nga kompani private të vogla.**
- ✧ **Kontrolli i shtetit ndaj shfrytëzuesve të digave të mëdha sipas kërkesave të ligjit, nuk është kryer nga Ministria e Infrastruktës dhe Energjisë (MIE) dhe nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural që mbulojnë fushën e qëllimit të tyre kryesisht për shkak të mosfunksionimit të Grupit të Sigurisë së digave pranë këtyre Ministrive të kërkuar në legjislacionin përkatës, mangesive të organizimit të Inspektoriatit teknik të digave pranë MIE, mungesat logjistike në lidhje me kontrollet në terren, mungesave të një baze të dhënash të monitorimit të digave nga shumica e shfrytëzuesve të tyre, mungesa e informacioneve nga shfrytëzuesve të digave sipas kërkesave të legjislacionit**
- ✧ **Shumica e shfrytëzuesve të digave të mëdha që përdoren për qëllime ujitje dhe peshkim, nuk kanë dokumentacionin teknik të projekteve të zbatimit të punimeve për digat dhe Pasaportat e digave me të dhënat teknike kryesore të tyre.**

- ✧ **Shumica e Shfrytëzuesve të digave të mëdha që përdoren për qëllime ujitje dhe peshkim nuk kanë njesitë e drejtimit teknik për kontrollin, monitorimin dhe sigurinë e digave të mëdha gjatë shfrytëzimit duke mos respektuar kërkesat e nenit 29 të VKM nr. 147, datë 18.03.2004. Eshtë një kerkese urgjente që shfrytëzuesit e digave të mësipërme të krijojnë urgjentisht pozicionin e inxhinierit të digës/ njesisë së drejtimit teknik për sigurinë e digave me specialiste të kualifikuar duke përcaktuar në mënyrë të qartë të gjitha detyrat dhe të drejtat e tyre gjatë procesit të shfrytëzimit, mirëmbajtjes, kontrollit, monitorimit dhe sigurisë së digës.**
- ✧ **Në sektorin e digave të mëdha ka mungesa të standarteve bashkekohore teknike. Eshtë një kerkese imediate, hartimi dhe miratimi i standarteve teknike kombetare për monitorimin e digave të mëdha.** MIE në bashkëpunim me Institucione teknike dhe shkencore, KKDM, Akademinë e shkencave si dhe kompani konsulente me eksperiencë duhet të hartoj standarte teknike kombetare bashkekohore për monitorimin dhe sigurinë e digave të mëdha duke u bazuar në rekomandimet e ICOLD si dhe në standartet teknike të vendeve europiane me eksperiencë në këto fusha.
- ✧ **Shfrytëzuesit e digave dhe rezervuarëve që përdoren për ujitje dhe peshkim, nuk kanë matje dhe analiza të sedimenteve në rezervuarët e krijuar nga këto diga që prej mëse 20 vitesh, duke mos respektuar kërkesat e nenit 30 të VKM Nr. 147, datë 18.03.2004, sipas të cilës këto matje duhet të kryhen jo më vonë se çdo 5 vjet. Kjo situatë ka krijuar problematika të mëdha në menaxhimin e rezervave ujore në ujembledhësit e tyre.**
- ✧ **Digat duhet të konsiderohen realisht si objekte të rëndësise se vecante dhe me rrisht të lartë në rast të demtimeve apo prishjeve që mund t'ju ndodhin.** Shfrytëzuesit e digave duhet të marrin masat e duhura dhe të kenë prioritet plotësimin e kërkesave të përcaktuara në VKM Nr. 168, datë 24.03.2023 “Për Miratimin e vlerësimit të rrishtit nga fatëkqesite në nivel kombëtar”.
- ✧ **Mungon vlerësimi dhe rregjistrimi i aseteve të digave të mëdha që shfrytëzohen nga bashkitë dhe nga MBZHR.** Mëse 95 % e shfrytëzuesve të digave, nuk e kanë të llogaritur vlerën e pasurive të paluajtshme për digat dhe rezervuarët e krijuar prej tyre. Ato nuk i kanë rregjistruar digat dhe rezervuarët në Agjencinë Kombëtare të Kadastrës. Shfrytëzuesit e digave për qëllime ujitje dhe peshkimi në bashkëpunim me prefekturat dhe MBZHR duhet të perfundojnë procesin e vlerësimit dhe rregjistrimit të aseteve të digave sa më shpejt të jetë e mundur dhe të hartohet një regjistër kombëtar i vlerës së këtyre aseteve
- ✧ **Në mëse 97 % të digave të mëdha nuk ka të instaluar sisteme të alarmit dhe nuk kanë ndërtesat e kërkuara për kontrollin dhe shërbimin e ruajtjes së digave. Kjo çështje është me theksuar në digat me rrisht të lartë të dhëna në Shtojcën Nr. 3 të këtij Raporti.**
- ✧ **Shfrytëzuesit e 95 % të digave të mëdha që përdoren për ujitje dhe peshkim, nuk kanë përgatitur hartat e përmbytjeve në rastet e prurjeve katastrofike apo të prishjeve të mundshme të ndonjë dige duke mos respektuar kërkesat e legjislacionit në fuqi. Në kushtet e popullimit të shume zonave poshtë digave si dhe të problematikave të vetë digave, është urgjente përgatitja e këtyre hartave dhe hartimi i rregulloreve dhe vendimeve perkatese në digat me rrisht të lartë për të marrë masat e duhura për të mos lejuar ndertime të reja në këto zona si dhe përgatitjen e planeve urbanistike që të marrin në konsideratë problemet që mund të ndodhin nga prishjet e digave.**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- ✧ **MIE dhe Institucionet ne varesi te saj në bashkëpunim me KKDM duhet të shqyrtoj mundësitë për krijimin dhe funksionimin e një ekipi për kryerjen e kontrollit shtetëror teknik 10 vjeçar të digave.** Si zgjidhje emergjente, rekomandojmë që të shikohet mundësia e kryerjes së këtij kontrolli nga Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore qe monitoron te gjitha HEC-et me diga te dhena me koncesion ose Instituti i Ndertimit i cili jo vetëm që është pjese e strukturave te MIE por ka edhe kapacitetet teknike të nevojshme për kryerjen e këtij kontrolli. KKDM është e gatshme të kontribuojë dhe të bashkëpunojë në këto kontrolle teknike duke përgatitur udhëzuesit përkatës dhe rregullat që duhet të zbatohen gjatë këtyre kontrollove si dhe shqyrtimin dhe miratimin e raporteve të kontrollit.
- ✧ **Shfrytëzuesit e digave të mëdha që përdoren për ujitje dhe peshkim në bashkëpunim me MBZHR, duhet të organizojnë procesin e përgatitjes së dokumentacionit teknik të këtyre digave sipas udhëzimeve të dhëna nga KKDM.** Ky proces duhet të shoqerohet edhe me një proces për përditesimin e të dhënave teknike të këtyre dosjeve përmes matjeve në terren.
- ✧ Bashkitë në bashkëpunim me MBZHR duhet të organizojne trajnime të stafëve teknike për monitorimin, mirëmbajtjen dhe sigurinë e digave të mëdha.
- ✧ Shfrytëzuesi i digës së HEC Moglicës (Devolli HP) duhet të vazhdoj monitorimin e thelluar në lidhje me uljet e evidentuara në kursorin e digës së Moglicës sipas udhëzimeve dhe rekomandimeve të dhëna nga KKDM dhe të informojë me raporte teknike të veçanta çdo 6 muaj KKDM, MIE dhe Këshillin e Ministrave;
- ✧ Shfrytëzuesi i digave të kaskadës së lumit Drin (KESH sh.a.) duhet të vazhdoj te kryejë monitorimin e thelluar ne kohe reale te sasise dhe cilesise se ujrave te filtrimeve ne dhembin e anes se poshtme te diges se HEC Koman sipas rekomandimeve te dhena nga ekspertet e fushes dhe KKDM duke kryer edhe analizat perkatese te rezultateve te ketyre matjeve, duhet te marre masat per përditësimin e rregullores se shkarkimit të plotave me fokus rritjen e sigurisë së digave të kaskadës se lumit Drin dhe menaxhimin e integruar të kësaj kaskade si dhe zvogelimin e rriskut te permbytjeve ne zonen e poshtme te digave te HEC Vau i dejes. KESH duhet të informojë me raporte teknike të veçanta çdo 6 muaj KKDM dhe MIE ne lidhje me këtë problematikë dhe rezultatet e monitorimit të këtyre filtrimeve. Në raste të vecanta apo përkeqesim te situatës duhet te pregatiten raporte teknike te vecanta me te shpeshta. Njekoheisht, KESH duhe te kryejë nje analize dhe studim te plote ne lidhje me mivelet e ujit dhe prurjet e ardhura ne kasakden e Drinit gjate 5 viteve te fundit duke i krahasuar me eventet dhe prurjet maksimale te ardhura gjate 50 viteve si dhe me te dhenat e projektit orgjinal duke bere te mundur peditesimin dhe njohjen reale te situates se menaxhimit teintegruar te kaskades se lumit Drin
- ✧ Shfrytëzuesit e digave të mëdha në bashkëpunim me Agjencine Kombetare te Mbrojtjes Civile duhet të kryejnë trainime dhe praktika në terren për zbatimin e detyrave të kërkuara nga Planet e gadishmërisë në rastet e emergjencave civile. Shfrytezuesit e ketyre digave permes nje koordinimi me Agjencine Kombetare te Mbrojtjes civile duhet te kryejne testimin e planeve te gadishmerise ne rastet e emergjencave civile perpara sezonit te dimrit;
- ✧ Bashkite që janë shfrytëzuese të digave të mëdha, duhet të përgatisin inventarin e digave të mëdha që kanë dalë jasht funksionit dhe kanë nevojë për projektet e duhura dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për dekomisionimin e tyre.